

Ushqim optimal gjatë fazës tranzitore - Kalim pa probleme në laktacionin e radhës

Referat nga z. Franz Riegler, konsulent dhe bashkëthemelues i Austria Praemix Shpk



Lopët me rendiment të lartë kanë një bilanc negativ të energjisë në fund të periudhës së barsmërisë dhe në fillim të laktacionit

Mobilizimi i tepërt i yndyrës trupore mund të shkaktojë një mbingarkesë të shpejtë të metabolizmit të mëlçisë. Pasojat janë ketoza dhe sindromi i mëlçisë së dhjamosur. Kjo shoqërohet me një status të reduktuar të imunitetit dhe rënie në mënyrë të konsiderueshme të fertilitetit. Në këtë fazë të rëndësishme tranzitore, aplikimi i produkteve të lëngshme dhe të thata të Schaumann (Austria Praemix sh.p.k) rezulton shumë i suksesshëm.

Në qendrën eksperimentale të kompanisë Schaumann është zhvilluar sëfundmi produkti special për mbrojtjen e rumenit, i cili është i pajisur me carnitinë dhe ka rezultuar shumë i suksesshëm. Bazuar në rezultatet pozitive, u krijua Rindavital C Plus, një përzierje substancash optimale me efekt të ndjeshëm mbimetabolizmin e energjisë në të ushqyerit e kësaj faze. Energizer

Schaumann C Plus është një suplement i avancuar për të përmirësuar furnizimin me energji në fund të periudhës së tharjes dhe gjatë laktacionit të hershëm.

Rindavital C Plus



Përveç carnitinës së mbrojtur, Rindavital C Plus përmban dhe glukozë, maja dhe vitaminë E. Kjo përzjerje e shijshme mund të përdoret në çdo racion ushqimor. Kontrolli i provave të gjakut tek lopët pas pjelljes, për acidet yndyrore të lira dhe beta-hydroxybutyrate, dha rezultate shumë pozitive. Grafiku 1 tregon rezultatet e beta-hydroxybutyrate në javën e parë dhe të tretë të laktacionit: që në javën e parë të laktacionit, konstatohet rënie e ndjeshme e kësaj vlere, të cilat vazhdojnë të bien përsëri në mënyrë të konsiderueshme dhe pas dy javësh. Edhe pse në këto kushte nuk mund të përjashtohet


demobilizimi i yndyrërave trupore, përsëri nuk kemi stres të mëlçisë. Ky lehtësim i metabolizmit kontribuon për një rendiment të lartë (shih grafikun.2). Që pas disa ditësh, lopët, tek të cilat u përdor Rindavital C Plus, shfaqën një ecuri të ndjeshme në rendiment, i cili arrin në 5 kg gjatë fazës kritike në javën e dytë dhe të tretë të laktacionit. Suksesi në praktikë konfirmon dhe rezultatet e eksperimentit. Efekt pozitiv është konstatuar edhe tek lopët simental me kondicion mbi normë, duke mundësuar start pa probleme në laktacionin e parë.

Rindavitali i ri C Plus është çelësi për:

- Një rritje e konsumit të ushqimit
- Forcimi i vitalitetit të viçave
- Rritja e rendimentit tek mëshqerrat dhe lopët
- Persistencë e përmirësuar e prodhimit të qumështit
- Reduktim i ndjeshëm i rrezikut të ketozës
- Fertiliteti sigurtë

Në një aplikim gjashtë-javor të Rindavital C Plus, rekomandohet përdorimi i 100g/ditë/lopë, për një aplikim tre javor rekomandohen 200g/ditë/lopë. Pas pjelljes mjaftojnë 100g në ditë për mbulimin e nevojave të organizmit.

Fig. 2:
Rendimenti i qumeshtit tek lopet me te vjetra
me apo pa perdorim te RINDAVITAL C PULS
qumesht kg/dite



Rindastar Start C Plus

Rindastar C Plus është një produkt i ri, inovativ në linjën e ushqimit të gatshëm, që përmban yndyrë të mbrojtur, methionine të mbrojtur, komponentë glucoplastikë, propilen glikol dhe glicerinë, vitaminë E, Niacinë, Biotinë, mikroelementë të lidhur organikisht, si edhe karnitinë për mbrojtjen e rumenit. Rindastar Start C Plus aplikohet më së miri gjatë fazës transitore. Gjatë kësaj periudhe, që shoqërohet me një bilanc negativ energjie dhe sintezë mikrobiale të reduktuar të proteinave, mundësohet nëpërmjet yndyrëve të mbrojtura një burim energjie me vlera të larta.

Komponentët glukoplastikë përbëjnë elementet bazë në sintezën e sheqerit në gjak, jetike për jetën e lopëve. Biotina, niacina dhe karnitina plotësojnë njëra tjetrën, mbështesin sintezën e sheqerit në gjak dhe kanë një efekt pozitiv në rumen dhe metabolizimin e energjisë. Me nxitjen e djegies së yndyrës ulet sasia e acideve të lira yndyrore, bie djeshëm mbingarkimi i mëlçisë. Të lidhur organikisht, zinku, bakri, mangani dhe seleni kanë një disponibilitet të lartë organik.

Doza më efektive është 1kg për lopë në ditë, duke filluar minimalisht tre javë para pjelljes. Pas kësaj periudhe, të ushqyerit duhet të vazhdojë me 1-1,5 kg për lopë në ditë.

Krijoni kushtet për pjellori më të lartë dhe rendiment të kafshëve tuaja! Me formulimin e ri rindavital C Start C Plus dhe Rindastar C Plus lopët janë të përgatitura mirë për fazën e tranzicionit.